



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-4726/15</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>10-12-2015</u>
Nr. pages	Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.11.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4288/15, për zyrtarin e lartë z. Isa Hajrizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4288/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Isa Hajrizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit është identifikuar se zyrtari i lartë z. Isa Hajrizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si pronar dhe person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051 kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Isa Hajrizi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është njoftuar për situatën në të cilën gjendet.

z. Hajrizi, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qen i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

Me datën 08.12.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Isa Hajrizi, ka bërë ndryshimet e kërkuara sipas ligjit duke e autorizuar një person si person të autorizuar në biznesin me emër N.P.T "KALTEX" dhe numër biznesi 70567911.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmara nga z. Isa Hajrizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë, duke bërë ndryshimet e parapara me ligjin në fuqi, në bazë të kësaj konsiderojmë se pasi janë krijuar rrethana të reja është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Isa Hajrizi, Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

